



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 975/2 prot.

Datë 09.05.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “NG Structures” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60492-02-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i Poliklinikes se Spitalit Rajonal Durrës*”, me fond limit 97.099.488 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “NG Structures” SHPK  
Lagja “Selam Musai”, Rruga “Dule Dalani”, Nr. Pasurie 14/324, Zona Kadastrale 3574, Kati i dytë, Tepelenë

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës  
Rruga “Aleksandër Goga”, Lagja Nr. 8, Durrës

Në datën 08.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3078, si dhe nr. protokollit 975/2023 datë 08.05.2023 e operatorit ekonomik “NG Structures” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60492-02-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i Poliklinikes se Spitalit Rajonal Durrës*”, me fond limit 97.099.488 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “NG Structures” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “NG Structures” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3078, si dhe nr. protokolli 975/2023 datë 08.05.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

- *Nuk përmbush kriteret sipas Shtojcës 2 “Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.” Konkretisht zëri A-6 Punime tavani, suvatimi dhe veshje,5. Punime 2,181 Konstrukione metalike të përbëra është ofertuar pa cmim.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.05.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**